

V E N D I M

Nr. 776, datë 8.12. 1998

PËR GRUMBULLIMIN DHE DEPOZITIMIN E DETYRUAR TË AUTOMJETEVE TË BRAKTISURA

Në mbështetje të ligjit nr. 7664, datë 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar dhe të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Sheshet për grumbullimin dhe depozitimin e automjeteve të braktisura përcaktohen nga këshillat e rretheve, me miratimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, mbështetur edhe në kërkesat e subjekteve, fizike dhe juridike.

2. Pronarët e automjeteve, që do të nxirren jashtë funksionimit, të bëjnë depozitimin e tyre në sheshet e përcaktuara sipas pikës 1 të këtij vendimi, nën mbikëqyrjen e organeve të policisë rrugore të Ministrisë së Rendit Publik.

3. Grumbullimi dhe depozitimi i automjeteve të braktisura ose i atyre që do të dalin jashtë funksionimit, të bëhet nëpërmjet licencimit të subjekteve fizike dhe juridike. Licencat jepen nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, sipas kriterëve të vendosura për këtë qëllim.

Kriteret për dhënien e licencave të kësaj veprimtarie vendosen nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministrinë e Rendit Publik, dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

4. Automjeti të pranohet nga subjekti i licencuar vetëm pasi ai të jetë i pajisur me dokumentin, që vërteton çregjistrimin e mjetit dhe dorëzimin e dokumenteve dhe targave në organin që bën regjistrimin.

5. Fondet për veprimtarinë e grumbullimit dhe të depozitimit të automjeteve të braktisura, që do të dalin jashtë funksionimit, përballohen nga subjektet e licencuara.

6. Kundrejt pronarëve, që braktisin automjetin, jashtë vendeve të përcaktuara nga këshilli i rrethit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të merren masa administrative, në përputhje me ligjin nr.7664, datë 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Rendit Publik, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe këshillat e rretheve për hartimin e rregulloreve, caktimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Pandeli Majko**

